



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

**të mbledhjes së katërt të Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur më 18.04.2019,
duke filluar në orën 15:00.**

Në mbledhje morën pjesë: Agim Kuleta, kryesues i Komitetit, anëtarët e Komitetit: Vala Peshku, Halim Halimi, Agim Gashi, Jeta Rafuna, Sami Boroci, Eman Rrahmani, Fadil Gashi, Genc Sherifi dhe Egzon Azemi.

Mungoi: Blerand Stavileci.

Në mbledhje morën pjesë edhe: Osman Bllaca, përfaqësues i ekzekutivit, Vasilika Zotaj, drejtoreshë e Drejtorisë së Administratës, Valbona Ahmeti - Makolli, drejtoreshë e Drejtorisë së Financave, Fatos Dibra, përfaqësues i Zyrës ligjore, Brahim Mehmetaj, drejtor i Drejtorisë së Pronës, Bujar Gashi, drejtor i Drejtorisë së Shëndetësisë, Premtime Preniqi, koordinatorë për të drejtat e njeriut dhe barazi gjinore, Qëndrim Arifi, përfaqësues nga INPO-ja, Faton Ajeti, përfaqësues nga OSCE-ja dhe Fahri Krasniqi, përfaqësues nga "Hendikos".

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi **Agim Kuleta**, kryesues, me këtë

REND DITE:

- 1. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe të mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa;**
- 2. Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 janar - 31 mars 2019 (TM1);**
- 3. Propozimvendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës (PMQU);**
- 4. Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, 01. nr. 046-295921, të dt. 06.12.2016, të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Qendrës së Arteve të Kosovës;**

5. Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS);
6. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ilir (Ajet) Sogojeva, Sabri (Ajet) Sogojeva, Ajet (Sami) Sogojeva, Albulena (Sami) Sogojeva dhe Agron (Sami) Sogojeva;
7. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Salih (Hamdi) Berishës;
8. Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Visar Sylejmanit;
9. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKBS);
10. Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e tarifave për transport të pacientëve dhe caktimin e tarifave për qytetarët jorezidentë të Prishtinës;
11. Të ndryshme.

Kryesuesi hapi diskutimin lidhur me rendin e ditës.

Premtime Preniqi propozoi që për Kuvend të futet si pikë e rendit të ditës "Propozimvendimi për lënie në shqyrtim publik të Projektregullores për themelimin dhe strukturimin e Asamblesë Komunale të Fëmijëve".

Brahim Mehmetaj propozoi që për Kuvend të futet si pikë e rendit të ditës "Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Azemine (Hamit) Gashit".

Kryesuesi premtoi se do të bisedojë me Kryetarin, ashtu siç e parasheh procedura, dhe i fusim në rend dite për Kuvend, në mënyrë që t'u shkojnë materialet me kohë.

Pika e parë

Miratimi i ekstraktit të procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Agim Gashi tha se në mbledhjen e jashtëzakonshme, rreth Propozimit për bartjen e buxhetit, në diskutimin tim unë kam thënë lagjja "Kullaj", ndërsa në procesverbal është shkruar "Bullaj", andaj të përmirësohet dhe ku është shkruar "Bullaj" të jetë "Kullaj".

Kryesuesi konstatoi se njëzëri u miratuan ekstrakti i procesverbalit të mbledhjes së tretë dhe mbledhjes së jashtëzakonshme të Komitetit për Politikë dhe Financa, me përmirësimin e cekur.

Pika e dytë

Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 janar - 31 mars 2019 (TM1).

Valbona Ahmeti - Makolli tha se ky Raport TM1 - 2019, është përgatitur në bazë të Ligjit që është në fuqi për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Gjatë kësaj periudhe raportuese Komuna e Prishtinës ka realizuar të hyra në vlerë prej 6,476,879.60 €, apo 20.41% të të hyrave të planifikuara për vitin 2019.

Krahasuar me periudhën e njëjtë kohore të vitit 2018, kemi një rritje prej 17.28% të të hyrave vetanake.

Sa i përket investimeve kapitale, të gjitha këto shpenzime të cilat janë të paraqitura në raportin që e kemi dërguar, janë projekte të vitit 2018, të bartura në vitin 2019.

Vetëm për informacion lidhur me bartjen, kemi pritur 16 ditë kalendarike MAPL-në për kthimin e përgjigjes, nuk na ka kthyer përgjigje, dje i kemi publikuar Vendimet, meqenëse 18 ditë e kemi kërkuar raportin në Ministrinë e Financave për alokimin e mjeteve.

Komuna e Prishtinës në këtë periudhë 3-mujore, për projektet kapitale që i ka planifikuar për vitin 2019, që janë 126 projekte kapitale, disa janë vazhdim prej viteve të mëhershme, diku 70% kërkesa janë dërguar në Zyrën e prokurimit për realizim deri më 30.03.2016.

Pagesat me përmbnim nga Ministria e Financave, neni 39.2, për këtë periudhë është 247,317.09€.

Në raporte kemi kërkuar sqarim për secilën, se çka janë bërë këto pagesa, në mënyrë që në 6-mujorin e parë me i pasur në mënyrë tabelore.

Ajo çka është shqetësuese për Komunën, janë detyrimet kontingjente, të cilat edhe në këtë vit vlera raportuese arrin 9,699,688.85 €.

Halim Halimi tha se ne e dimë që të hyrat e planifikuara për vitin 2019 janë 31,733,984.00 €, prej të hyrave në këtë 3-mujor janë realizuar 6,476,879.60 €, në katër tremujorë deri në fund të vitit ofrohet d.m.th. te planifikimi 31 milionë, d.m.th. sa i përket të hyrave mund të themi mirë, mirëpo nëse e analizojmë shifra prej 31 milionë është që janë planifikuar. Atëherë unë mendoj se është planifikim jo i mirë, për shkak se 31 milionëshi ka qenë i planifikuar para 5 vjetëve dhe qe 5 vjet ne sillemi te 30 milionëshi i të hyrave.

Nëse shkojmë te shpenzimet, shpenzimet buxhetore kanë arritur 12,272,712.81 €, këto shpenzime, me përjashtim për shpenzimet për paga e mëditje - 7milionë, shpenzimet në mallra dhe shërbime - 3 milionë, tash pyesim çka është bërë me investime kapitale, shihet se 1 milion e diçka, a e dimë mirë sa ka buxhet për shpenzime kapitale, d.m.th. as 3% të buxhetit nuk është shpenzuar në shpenzime kapitale. Është shumë shqetësuese, se kanë kaluar 3 muaj dhe shumica e drejtorive kanë shpenzime 0 € edhe ato të tjerat që janë 10-12 %!

Sami Boroci theksoi se në Kuvend do të bëjë pyetje për drejtori të caktuara, mirëpo unë desha me kërkuar, këtu po e shoh një listë te këto detyrimet kontingjente, po e shoh si kompensimi, dëmshpërblimi, nëse mundeni me zbërthyer këtë, saktësisht me ditë çka janë këto lëndë, apo detyrime që Komuna e Prishtinës i ka në raport. Ndoshta kishte qenë mirë me pasur një listë më të detalizuar me pa çka janë këto.

Fatos Dibra bëri të ditur se nuk ka mundësi që shumë të dhëna me i futur për një padi.

Sami Boroci tregoi interesim se të cilës natyrë janë këto detyrime, vetëm kompensim dëmi e asgjë më shumë.

Fatos Dibra tha se mund t'u sugjerojmë drejtorëve me përfshi më shumë të dhëna.

Vala Peshku kërkoi të sillet një raport i veçantë.

Agim Gashi kërkoi sqarim nga drejtoresha për, siç thuhet "shpenzimet për anëtarësim".

Valbona Ahmeti - Makolli bëri të ditur se shpenzimet e Asociacionit të Komunave, ku në bazë të numrit të banorëve secila komunë e paguan anëtarësimin.

Agim Gashi, sa i përket vlerave të prezantimit të raportit, drejtoresha shpjegoi që shpenzimet kapitale janë kryesisht projekte nga mjetet e bartura, për të cilën desha të parashtrij pyetje, se a ka projekte që janë realizuar nga mjetet e bartura, kështu që u përgjigj dhe e kuptova, por nuk po e kuptoj që po thoni buxheti i Komunës së Prishtinës është 87 milionë.

Valbona Ahmeti - Makolli tha se ende nuk janë alokuar mjetet.

Agim Gashi tha se ne e kemi miratuar në Kuvend një buxhet të bartur dhe ajo është vlerë reale që nuk kontestohet, sepse është realitet dhe askush nuk mundet ta kontestojë, as niveli qendror, meqenëse e kemi një dokumente valid që do të miratohet në Kuvend, duhet me i pasur pasqyrat reale. Ne po e miratojmë një raport tash që po i mungojnë 25 milionë vlerë, dhe tash në kuptimin financiar nuk jemi real, sepse të gjitha rezultatet statistikore nuk janë të sakta, ajo e tregon, ne kalkulojmë mbi bazën 87 milionë dhe këtu thamë se janë shpenzuar mjetet e bartura, e tash nuk i fusim në pasqyrim financiar ato mjete. Ju drejtoreshë, po e arsyetoni se Qeveria është vonuar, ne e dimë këtë gjë, por është mirë me prezantuar, pavarësisht a e ka kthyer përgjigje a jo, dhe nëse e kontestojnë ata, ne jemi këtu, por nuk kanë pse e kontestojnë, se mjetet janë të bartura, ato ekzistojnë.

Vala Peshku theksoi se Ministria nuk ka kthyer përgjigje, siç e përmendi, për 15 ditë, dhe tashti ka hyrë në fuqi.

Agim Gashi tha pse pra nuk është pasqyruar. Mirë do të ishte që për mbledhjen e Kuvendit me u përmirësuar këto gjëra, që mos të ngrihen prapë të njëjtat probleme.

Vala Peshku pyeti se këto raporte dhe këto shënime a nxirren prej një sistemi, prej një data-bazë, e që është Thesari.

Valbona Ahmeti Makolli dha sqarimet e nevojshme.

Egzon Azemi theksoi se taksa për shfrytëzimin e hapësirave, sipërfaqeve publike, në vitin 2017 ka qenë 99,699.22 €, ka një zbritje drastike në vitin 2018, është më shumë se gjysma. A ka ndonjë koment për këtë çështje, sepse thuajse të njëjta sipërfaqe shfrytëzohen zakonisht me kafeteri etj.?

Fatos Dibra tha se këtë çështje e ka Drejtoria e Shërbimeve Publike.

Egzon Azemi u shpreh se te Inspeksioni është normalisht taksa për leje ndërtimi. Në vitin 2017, shihen të hyrat nga kjo kategori, që janë 2,540,776.00€, ndërsa në vitin 2018 janë gjysmë milioni euro më pak të hyra me leje ndërtimi. Nëse themi ka pasur më pak ndërtime në vitin 2018 në krahasim me vitin 2017, realisht mund të jetë e kundërta, sepse ndërtime ka pas më shumë, por a janë me leje apo pa leje, është çështja që kërkon shpjegim.

Brahim Mehmetaj tha se nuk janë tema tona, janë në Inspeksion, i takon Urbanizmit, se Urbanizmi inkason mjete prej lejeve të ndërtimit. Sa i përket asaj se a ka pasur më shumë apo më pak ndërtime në Prishtinë, veç mbetet me u paramenduar se mundet, mendohet me pasur më shumë, por ka pasur shumë më shumë me leje.

Egzon Azemi tha se nëse ka pasur me leje më shumë në vitin 2018, është dashur të hyrat me qenë më të mëdha!

Fatos Dibra bëri të ditur se kanë ndryshuar tarifat. Po të ishte Ardiani e kishte shpjeguar më mirë.

Valbona Ahmeti - Makolli tha se unë mund t'ua përcjellë dy drejtorëve që keni bërë kërkesë, me siguri në Kuvend ju japin përgjigje.

Kryesuesi pyeti drejtoreshën se a ka kohë dhe mundësi edhe këtë pjesën që e tha z. Agimi, me përmbledh për mbledhjen e radhës.

Agim Gashi tha se në aspektin formal e keni mostrën, vetëm shtohet vlera, por ju bëni mirë deri në Kuvend me na i dhënë të përpunuara, me gabime më pak të mundshme, dhe i bëni nder institucionit.

Valbona Ahmeti - Makolli u shpreh se ne mundemi me i marrë dhe me i qitë si shumë, por me i kalkular këto me i prishur nuk mundemi, se pse duhet prapë me i nxjerrë prej sistemit.

Agim Gashi tha, ju po thoni pa e marrë vlerësimin nga Ministria përkatëse për alokimin e mjeteve, atëherë si i keni paguar projektet nëse s'kanë qenë të alokume mjetet, d.m.th. ka pasur të alokuara dhe jo të akoluara.

Valbona Ahmeti - Makolli tha se mjetet e alokuara të vitit 2019, disa nga projektet të cilat janë në vazhdim, d.m.th. që dekorimi i qytetit është për 3 vjet, shkon çdo vjet, ne i kemi paguar me mjetet e vitit 2019 dhe momentin që bëhet alokimi i mjeteve, ne e bëjmë harmonizimin e tyre, por ka projekte që nuk janë në vitin 2019.

Agim Gashi tha se ne po flasim për një buxhet që e ka në dispozicion Komuna e Prishtinës, që është tërësisht 112 milionë € e diçka, duke e marrë parasysh që edhe 25 milionëshi i bartur, dhe ne nuk po i kontestojmë ato obligime ligjore dhe procedurat në raport me Ministrinë, por ne e kemi këtë vlerë që është miratuar nëpër vendimet e Kuvendit, është miratuar 87 milionëshi dhe 25 milionëshi. Unë po kërkoj që këto të dyja me i bashkuar e me i prezantuar këtu. Kjo e ka bazën e plotë ligjore, andaj s'ka nevojë me pritur Ministrinë, ne e kemi planifikuar këtë buxhet, ky buxhet i planifikuar është miratuar, këtë po e prezantojmë, asgjë më shumë se që është miratuar në Kuvend.

Kryesuesi i tha drejtoreshës se rekomandimet i more dhe shiko për mbledhjen e radhës çka është e mundur ta bëni.

Valbona Ahmeti - Makolli tha se për të enjten nuk është e mundur të bëhet, tek për të martën planifikoni për Kuvend.

Kryesuesi tha Kuvendi nuk i ka, i shkojnë me vonesë materialet.

Eman Rrahmani theksoi se ka shumë pika që materialet na dërgohet me vonesë, kështu që edhe materiali i kësaj, nëse vjen të martën, në një pjesë e kemi, këtë që e kemi me i bashkangjitur edhe atë plotësuesin.

Kryesuesi u shpreh se materiali mundet t'u përcillet asamblistëve me kohë, d.m.th. nesër ky që është, e mandej çka është plotësues mundet me u dërguar komplet.

Valbona Ahmeti - Makolli u shpreh se do të shikojmë me Ministrinë se çka mund të bëjmë, për mua nuk është problem.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Raporti për gjendjen financiare buxhetore për periudhën 1 janar - 31 mars 2019 (TM1), me materialin plotësues, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tretë

Propozimvendimi për lënien në shqyrtim publik të Projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës (PMQU).

Kryesuesi tha se ky propozimvendim është për ta dërguar në diskutim publik projektdokumentin për Planin e mobilitetit.

A ka diskutime rreth kësaj pike?

Agim Gashi pyeti se a do të bëhet prezantimi në Kuvend.

Kryesuesi bëri të ditur se një herë është bërë prezantimi i Planit të mobilitetit, i njëjtë është, një pjesë është prezantuar në Kuvend.

Agim Gashi tha se në Kuvend duhet të prezantohet komplet. Mundësisht, do të ishte mirë paraprakisht me na e dërguar atë material, me ua dërguar asamblistëve. Në formë të shkruar mund të mos e dërgoni, por në E-mail mund ta dërgoni.

Kryesuesi premtoi se do të flasë me drejtorin dhe do të kërkojë që të vijë ta bëjë prezantimin dhe materialin me e dërguar me kohë së paku në formë elektronike.

Shërbimi i Kuvendit e dërgon likun të të gjithë asamblistët, pastaj e bashkëngjit në faqe ku është materiali.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit për Planin e mobilitetit të qëndrueshëm urban të Prishtinës (PMQU) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e katërt

Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, 01. nr. 046-295921, të dt. 06.12.2016, të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Qendrës së Arteve të Kosovës.

Brahim Mehmetaj bëri të ditur se është një gabim dhe kërkohet që të bëhet përmirësimi i numrave të parcelave që janë shkruar gabimisht.

Kryesuesi tha se numri i parcelave do të përmirësohet.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndryshimin dhe plotësimin e Vendimit, 01. nr. 046-295921, të dt. 06.12.2016, të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale Qendrës së Arteve të Kosovës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e pestë

Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS).

Egzon Azemi theksoi se më shumë duhet ngrit këtë në seancë, sepse ka disa vende ku KEDS-i është duke kryer punë, duke i vendosur këto trafo. Çështja është se çfarë leje iu ka dhënë Komuna në këtë rast dhe kush e merre përgjegjësinë për dëmet që shkaktohen. P.sh. në lagjen "Kodra e Trimave", në rrugën "Shala e Bajgores", gjatë ndërrimit të shtyllave elektrike ku janë hequr shtyllat e drurit dhe janë vendosur shtyllat e betonit, janë dëmtuar disa drita. Për këtë banorët kanë kërkuar nga KEDS-i me i rregulluar, mirëpo ata iu kanë thënë shkoni Komunë. Këtu më së shumti po pësojnë qytetarët. Ajo lagje ka bërë peticion dy herë për rregullimin e ndriçimit që është bërë më 2018.

Njëherësh ngriti çështjen e laurës që është vendosur në lagjen "Veterniku", ku drejtori i Inspeksionit thotë se nuk kanë marrë leje për atë laurë dhe në vend se të thotë ne do të intervenojmë që menjëherë me larguar, se diçka që është vendos pa leje menjëherë duhet me u larguar. Nëse jepet leje nga Shërbimet Publike, atëherë është diçka tjetër. Ata mund të vendosin prapë, se ajo është vendosur pa leje dhe po qëndron aty ende, që i ka bllokuar 8 familje, vetëm pse nuk i takojnë nivelit të lartë politik e shtetëror.

Agim Gashi shprehu mendimin se çështjen e ndriçimit duhet ngritur te Shërbimet Publike, sepse Komuna gjithmonë ka një kontraktues për mirëmbajtjen e ndriçimit, pavarësisht kush e bën dëmin, kompania është e obliguar me proceduar për rregullim sipas kontratës, me sanuar gjendjen, ne duhet me ngritur këtë çështje se nuk është duke ndërhyrë.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për dhënien e pronës së paluajtshme në shfrytëzim Kompanisë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KEDS) dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e gjashtë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ilir (Ajet) Sogojeva, Sabri (Ajet) Sogojeva, Ajet (Sami) Sogojeva, Albulena (Sami) Sogojeva dhe Agron(Sami) Sogojeva.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarëve Ilir (Ajet) Sogojeva, Sabri (Ajet) Sogojeva, Ajet (Sami) Sogojeva, Albulena (Sami) Sogojeva dhe Agron(Sami) Sogojeva, dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e shtatë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Salih (Hamdi) Berishës.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Salih (Hamdi) Berishës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e tetë

Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Visar Sylejmanit.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të Visar Sylejmanit dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Pika e nëntë

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKBS).

Kryesuesi konstatoi se u miratuan Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për themelimin e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKBS) dhe dërgohen në Kuvend për miratim.

Pika e dhjetë

Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e tarifave për transport të pacientëve dhe caktimin e tarifave për qytetarët jorezidentë të Prishtinës.

Bujar Gashi e prezantoi këtë pikë, duke cekur se kujdesi shëndetësor është i organizuar në tri nivele, parësor, dytësor dhe tretësor. Komunat janë të obliguara dhe përgjegjëse për

kujdesin parësor, shëndetin publik, prandaj gjithmonë duhet vlerësuar gjendjen shëndetësore të qytetarëve në territorin e tyre.

Sipas ligjit për shëndetësi, neni 57, nga mjetet për financim në kujdesin shëndetësor janë edhe bashkëpagesat nga shfrytëzuesit e shërbimit shëndetësor, të cilët, në pajtim me ligjin, nuk janë të liruar nga pagesa, prandaj një kategori e popullatës së Kosovës, rreth 60%, janë të liruar nga bashkëpagesat, pra shërbimet shëndetësore për ta ofrohen falas.

Mjetet e mbledhura nga të hyrat vetjake me bashkëpagesat të shërbimeve shëndetësore, janë para publike dhe trajtohen sipas Ligjit mbi menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe rregullave financiare të thesarit të Udhëzimit administrativ 04/2007.

Sipas këtij Udhëzimi, neni 3, paragrafi 3.3, institucionet publike shëndetësore që detyrohen të mbledhin bashkëpagesa nga shfrytëzuesit e shërbimeve shëndetësore, janë Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare dhe njësitë e tyre. Ndërsa në paragrafin 3.10, parashihen edhe bartësit e sigurimeve shëndetësore të huaja, çmimi i bashkëpagesave duhet të jetë 5 herë më i lartë sesa çmimi i bashkëpagesave për qytetarët e Republikës së Kosovës.

Pas konsultimeve ligjore dhe konsultimeve me komisionin dhe Komitetin e Shëndetësisë të Komunës së Prishtinës dhe krerëve të institucioneve shëndetësore, propozojmë që banorët jorezidentë të komunës t'i mirëpresim në ofrimin e shërbimeve shëndetësore të qasshme dhe cilësore, mirëpo pagesa për shërbime të tyre të jenë 3 herë më të larta.

Agim Gashi u shpreh se si po e kuptoj unë, banorët që janë të komunave tjera ju shtohet taksa për shërbime 3 herë. Nuk jam marrë me ligjet e shëndetësisë, por sa kanë autonomi komunat me rregulluar këtë fushë, duke marrë parasysh që një grant të veçantë Komuna e Prishtinës e merr nga Qeveria, edhe komunat e tjera e marrin, pastaj Ligji për Prishtinën ia ka rritur buxhetin Prishtinës për 13 milionë e diçka, ku përfshihen edhe fusha e shëndetësisë, si mjete shtesë për shkak të shërbimeve që ofrohen nga kryeqyteti për banorët jorezidentë dhe obligimet ndërkombëtare që i ka në rolin e kryeqytetit.

Unë kisha thënë se më humane është me kërkuar rritje pasi të grumbullohen informacionet dhe të kemi statistika të sakta se Komuna e Prishtinës sa ofron shërbime për qytetarët jorezidentë dhe t'i drejtohet Qeverisë që ta ketë parasysh në rritjen e granteve, ose të gjejë një mënyrë tjetër, e jo t'i sanksionojmë qytetarët e komunave tjera, si Obiliqit, Fushë-Kosovës etj. Unë mendoj se është mirë me analizuar edhe një herë dhe me shikuar këtë punë e mos me i ngarkuar qytetarët.

Bujar Gashi tha se qytetet tjera janë më të vogla, si Obiliqi, Fushë-Kosova etj., të gjitha kanë shërbime cilësore dhe është i njëjti kualifikim i mjekëve që punojnë. Problem tjetër, ata po vinë, sipas statistikave, një pjesë e tyre vijnë me marrë udhëzim, d.m.th. është një shërbim që mundet me u marrë në çdo ordinancë dhe çdo pikë të Mjekësisë Familjare.

Agim Gashi theksoi se unë si këshilltar, këshilloj që ta rishqyrtoni këtë, se po dilni jashtë kornizës humanitare.

Sami Boroci u shpreh se prej prezantimit tuaj, drejtor, nuk është që po më tingëllon më së miri, d.m.th. kjo ndoshta kishte me pasur nevojë me shpjeguar ende në Kuvend. Unë tash për tash mendoj se kam me votua kundër. Nuk jam në dijeni si funksionojnë Qendrat e Mjekësisë Familjare, nuk e di a ka numër të madh të punëtorëve, a janë shumë të ngarkuar me pacientë, mirëpo në parim mendoj unë dhe AKR-ja, se kemi me qenë kundër, ose duhet ndoshta një tarifë minimale, por tash një tarifë e trefishtë mund të jetë pak ma e madhe.

Bujar Gashi tha sqarime, duke cekur se në komunën e Prishtinës numri i punëtorëve shëndetësor është 871, prej vitit 2002. Prej atij viti janë hapur edhe 10 QMF dhe nuk është rritur numri i punëtorëve shëndetësorë. Mundësia, kapaciteti njerëzor profesional për me i mbuluar mirë, me i dhënë këto shërbime janë të pakta, sidomos gjatë muajve të verës është e pamundshme me i mbuluar. Kemi Dardaninë, një mjek kontrollon mbi 50-60 pacientë, është e pamundshme me i mbuluar.

Eman Rrahmani tha se ne si Lëvizje Vetëvendosje nuk e mbështesim këtë iniciativë, e tillë si është, mendoj se është diskriminuese për qytetarët e komunave tjera, dhe në mënyrën siç e paraqiti drejtori nuk është shërbimi si në Prishtinë, si është në Obiliq, Fushë-Kosovë etj. Është dallimi si dita me natë, se është dallim prej drejtorit Arben, për punën si e ka bërë, ku ka arritur me bërë ndryshime, dhe nuk mundet me mohuar askush punën e tij, andaj është rritur kërkesa prej qyteteve tjera për me marrë shërbime në komunën e Prishtinës, se shërbimi dallon shumë prej komunave të tjera. Unë kërkoj nga Drejtoria që gjatë punësimeve të mos pranojë të punësuar që nuk arrijnë me kaluar testin, e t'i largojnë ata që dalin të parët në test. Kërkesë e jona është të fokusohet më shumë në shërbimet cilësore sesa në diskriminimin e qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Vala Peshku u shpreh se unë po i shohë dy kërkesa këtu, është kërkesa për rritjen e taksave 3 herë për shërbime dhe kërkesa për rritjen e tarifës për transport, që i bie 30%, ku sipas dokumentit të vitit 2008, shërbimet brenda territorit të Republikës së Kosovës, për km është 0.35 €, ndërsa ju po kërkon 0.50 €, që me përqindje i bie 30%, por me pasur të qartë këtë rritje secili prej nesh, dhe jashtë këtij vendi duhet me prezantuar dokumentacion pse po kërkohet kjo rritje, në bazë të cilës statistikë është kjo rritje, se nuk mundeni thjeshtë me aprovuar Vendim për ndryshimin e tatimit të tarifës, duke thënë se do të jetë 3 herë më e lartë, të arsyetohet se në cilat baza.

Fatos Dibra tha se këtu po shkruan se janë 3 herë më të larta se ato të përcaktuara me Udhëzimin administrativ 04/2007, në fund të Udhëzimit e ke tabelën, ku e ka përshkrimin e shërbimit dhe çmimet.

Vala Peshku pyeti se çka është ideja me këto, sa ne do të mund ta proklamojmë se jemi me u ofruar shërbime, por ne jemi duke bërë diskriminim, ku e rritë tarifën 3 herë pse qytetari vjen nga një vendi tjetër, ky në thelb është diskriminim dhe është kundër parimit të të drejtave të njeriut.

Fadil Gashi theksoi se më e rëndësishme është çështja e punësimit, se i kryen shërbimet siç duhet, se ato tarifatat që u përmendën nga drejtori, ai person që është mjek dhe punëtori siç duhet, ai kryen shërbime më të suksesshme sesa me marrë çfarëdo njeriu me shti në punë, se nuk mund të krahasohet Komuna e Obiliqit, Fushë Kosovës etj. me Komunën e Prishtinës, për atë arsye vijmë për shërbim në Prishtinë.

Egzon Azemi u shpreh, ju thoni, drejtor, se shumica vijmë për udhëzime, por një pjesë janë që nuk vijmë për udhëzime. Pa marrë parasysh për çka vijmë, me gjithë dëshirë nuk ishin ardhur në Prishtinë po të kishin ndonjë qendër më afër në fshat apo komunë; një, është transporti dhe dy, është rritja 3 herë më e lartë se tarifatat që kanë qenë, dhe kjo definitivisht është diskriminim. Nëse çështja është te udhëzimi, atëherë mundesh me specifikuar një rritje vetëm te udhëzimi, p.sh. me bërë një rritje 50% më shumë, është 1€, me bërë 1.50 € për ata që janë nga komunat tjera.

Bujar Gashi tha se megjithatë rritja është, si të dush merre, nëse është 50% apo 100% është prapë rritje.

Egzon Azemi tha është rritje, por nuk është si të ketë rritje 3 herë më shumë, si 50 centë, se kishit mundur me e sjellë të paktën më mirë, por edhe ashtu me sjellë, prapë nuk besoj se do ta votojmë, se prapë se prapë është diskriminim.

Brahim Mehmetaj propozoi që këto takime me u bërë me video incizim. Sigurisht mbas disa vitesh, por edhe tash kishin me qenë interesante për You Tube!

Kryesuesi bëri të ditur se të gjitha takimet janë të incizuara.

Brahim Mehmetaj me video kishin dalë më mirë. Ndërsa ideja e drejtoritë është për me siguruar një të drejtë të qytetarëve të Prishtinës për një shërbim më të mirë. Ju me këtë proces duhet me parë idenë, jo numrat, jo taksat. Unë po dua me dalë këtu, se qytetarët e Prishtinës janë të diskriminuar gjithmonë në punësim, avancim, shkollim dhe gjithkund, prej pas luftës e deri tani, asnjë të drejtë ne nuk mund ta realizojmë në asnjë komunë tjetër të Kosovës.

Ne e kemi një problem, e duam apo nuk e duam këtë qytet! Nëse e duam, atëherë duhet të punojmë më shumë për këta qytetarë. Unë po flas me statistika, 87% është kalueshmëria në testin e arritshmërisë në Skenderaj, ndërsa në Prishtinë del 40 % e diçka, të Skenderajt vijmë në fakultete dhe ia zë vendin të rinjve të Prishtinës, ku të rinjtë e Prishtinës mbesin jashtë fakulteteve. Nëse unë dua me siguria shërbim më cilësor, unë shkoj në institucionet private edhe ata që janë Glllogoc, Skenderaj etj. nëse duan shërbim më të mirë, le të shkojnë në shërbimet shëndetësore private, por nëse duan shërbim më të mirë në shtetëror, le t'i paguajnë 3 €.

Egzon Azemi tha se 80% janë përfitim për Prishtinën këto çështje që po i përmend, e jo dëm, siç je duke i paraqitur. Po thua për mësimdhënësit, Prishtina e ka fatin me një qeverisja të mirë, nëse ti i kishe marrë mësimdhënësit më të mirë, e ka fatin se i thirrë kuadrot më të

mira të të gjithë profesioneve me ardhur mi ligjërue të gjithë fëmijët e Prishtinës, e kjo është benifit për Prishtinën, se i punëson më të mirët si të Prishtinës, Gjakovës etj.

Brahim Mehmetaj tha, besoni se janë të diskriminuar banorët e Prishtinës në të gjitha fushat e jetës, janë të diskriminuar prej njerëzve të pandërgjegjshëm, si ata që e qeverisin nivelin qeveritar dhe këta nivelin lokal, janë të diskriminuar. Në lagjen time janë të punësuar vetëm 2%, në lagjen "Kodra e Trimave" po ashtu janë të punësuar vetëm 2% etj. Në Prishtinë i ke shumë pak njerëzit e punësuar, nuk kanë mundësi me kaluar nëpër konkurse.

Sami Boroci tha se drejtori e përmendi që kjo mbledhje duhet me u xhiruar. Unë e kam një ide të kahershme, që kam dashur ta propozoj në Kuvend. Tash seancat janë duke u transmetuar kohë pas kohe edhe në Face Boo, unë mendoj se asgjë nuk i kushton Komunës nëse e blenë një kamerë dhe me transmetuar drejtpërdrejt, në mënyrë pak më profesionale. Kjo është pak si masë, mendoj nëse donë me e marrë pak seriozisht. Unë mendoj se duhet me pasur një fotograf, duhet me pas një kamerë që e xhiron seancën, transmeton, njerëzit kanë nevojë me përcjell. Në anën tjetër, nuk pajtohem, unë mendoj se ne nuk kemi nevojë me i ndarë ashtu në rajone, se Kosova është vend i vogël, Prishtina është vend i mundësive që ofron për të gjithë.

Vala Peshku sugjeroi që të lexohet Kushtetutën e Republikës së Kosovës, për ta ditur se çfarë shteti dhe çfarë Republike jemi. Nuk jemi racistë. Nga ajo çka u tha këtu, çka ju po kërkoni, është në thelb diskriminim.

Fadil Gashi tha se ndryshe është me qenë nga Prishtina drejtori i Urbanizmit, i Inspeksionit etj. e ndryshe me qenë nga komunat tjera. Tjetër është me qenë drejtori i Arsimit i komunës tjetër, se ka drejtor që nuk i dinë as shkollat, nuk e ka shkelur territorin e komunës së Prishtinës, nuk e dinë ku është shkolla. Ne nuk jemi mos me i punësuar të tjerët, por me i dhënë përparësi atij të komunës së Prishtinës.

Vala Peshku tha se të gjithë duhet t'i kemi të drejtat e barabarta.

Eman Rrahmani tha racizmi më i madh që është duke ndodhur në punësim në Komunën e Prishtinës, nuk është duke ndodhur as në Qeveri e askund tjetër.

Kryesuesi shprehu mendimin se këtu në KPF disponimi nuk është që të kalojë kjo pikë në Kuvend. Merrni parasysh ato që u thanë këtu dhe vendosni për seancën e rrallës rreth pikës suaj.

A doni me dërguar, apo me ndryshuar diçka, të modifikuar, apo doni me e tërhequr pikën, drejtor?

Eman Rrahmani u shpreh se mendimi i VV-së është me e tërhequr pikën.

Kryesuesi tha, drejtori le të vendosë çka do të bëjë, shkon në seancë dhe votat vendosin a kalon a jo.

Brahim Mehmeti tha, kryesues, kjonuk është në rregull. Koalicioni qeverisës që e udhëheq Komunën e Prishtinës kur i propozon pikat për rend ditës, duhet me qenë të dakorduar në mes veti, jo me dalë partner koalicion me thënë jam kundër kurë e ka pru pikën këtu.

Kryesuesi konstatoi se u miratua Propozimvendimi për ndryshimin e Vendimit për caktimin e tarifave për transport të pacientëve dhe caktimin e tarifave për qytetarët jorezidentë të Prishtinës dhe dërgohet në Kuvend për miratim.

Mbledhja përfundoi në orën 16:30.

Procesmbajtësja
Shyhrete Islami

Kryesuesi i Komitetit
Agim Kuleta

